

VENDIM
Nr. 202, datë 1.10.2021

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBGAZ’ SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 12; të neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 123/4 prot., datë 29.9.2021, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të ndryshuar”,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 30.6.2021, vendosi:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që:

- a) brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore;
- b) brenda datës 30.9.2021, të depozitojë në ERE certifikatën e sigurimit.”.

- Dokumentacioni i cili duhet të plotësohet nga shoqëria “Albgaz” sh.a. deri në datën 20.9.2021, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188/2017, të ndryshuar, është si më poshtë:

- depozitimi në ERE i një certifikate sigurimi (neni 9, pika 1, germa “e”, “iv”), sipas “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar, që lidhet me certifikatën e sigurimit, deri në datën 20.1.2022, duke argumentuar se aktualisht ka nisur procedurën e prokurimit për përzgjedhjen e subjektit, i cili do të pajisë këtë të fundit me certifikatë sigurimi.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citon se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 153, datë 30.6.2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
KOMISIONERI
Adriatik Bego